

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA GLLOGOC**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **"REHABILITIMI I RRUGËS DHE NDERTIMI I TROTUARIT ARLLAT-NEGROVC DHE VUQAK"**

Nr i Prokurimit	611-25-5498-5-1-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	InfraCore Shpk
NUI	812169523
Adresa	Drenas
Vendi	Drenas
Kodi postar	13000
Numri Telefonit	049571977
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Brentian Mala
Adresa elektronike	<u>infracoreshpk@gmail.com</u>
Data e parashtrimit të kërkesës	04.07.2025

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-i
Adresa elektronike t

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Dosja e tenderit është publikuar me date 18.06.2025 nga AK Komuna e Drenasit

Kriteret e Dhënies: Tenderi i përgjegjshëm me çmim me të lirë
Hapja e tenderit është paraparë të bëhet me dt 11.07.2025

Duke u bazuar në Njoftimi për kontratë dhe Dosjen e tenderit, mendojmë se AK- Komuna e Drenasit, nuk ka rrespektuar, Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092LPP-së Paragrafi 1 i Neni 1, Paragrafi 1 i Neni 2, paragrafi 1 dhe 2 I Neni 6 dhe paragrafi 6 I Neni 7, si dhe **RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK Paragrafi 4.3 Neni 4.** Zyra e prokurimit, ka për obligim të shfrytëzon të gjitha mundësit me qëllim që mos të bënë shkelje të Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092LPP-së

Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike”.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

Jo X

Publikimi i Njoftimit për kontratë është bërë me dt 18.06.2025

Ne si OE kemi shpreh interesim për të qenë pjesëmarrës në këtë Aktivitet të prokurimit,

Hyrje në detaje të procedurës

Kërkesa për rishqyrtim bëhet lidhur me procedurën me titull: “REHABILITIMI I RRUGËS DHE NDERTIMI I TROTUARIT ARLLAT-NEGROVC DHE VUQAK” vlera e parashikuar për këtë projekt është 700,000.00 euro

Procedura është zhvilluar me afat të shkurtër me arsyetimin sipas AK: Kërkesa bëhet për arsye se mjetet financiare të dedikuara për këtë projekt janë nga Grandi i Përformancës dhe duhet shpenzuar brenda vitit fiskal 2025. Po ashtu edhe zotimin e mjeteve financiare nga ana e Ministrisë MAPL janë vonuar. çka ka ndikuar që të jemi të vonuar në procedura.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së /Qëllimi

Neni 2 i LPP-së /Fushëveprimi

Neni 6 i LPP-së /Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 i LPP-së/ Barazia në trajnim /Jo –Diskriminim

Neni 28 i LPP-së/ paragrafi 4 dhe 5 (Specifikimet teknike të pajisjeve nuk duhet të përshkruajnë emër komercial apo karakteristika që mundësojnë identifikimin e pajisjes specifike), i dhe shkelje të udhëzuesit zyrtar për hartimin e dosjeve të tenderit (versioni 002/2024).

Neni 52 i LPP-së/ Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhur

Neni 64 i LPP-së/ Dëshmitë e kërkesave

Neni 66 i LPP-së/ Përshtatshmëria Profesionale

Neni 69 i LPP-së/ Aftësitë teknike dhe profesionale

UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

Paragrafi 4.3 Neni 4

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

*Të nderuar përfaqësues të zyrës së prokurimit të Komunës së Drenasit, duke marr parasysh dëshmitë që kemi nxjerrura nga Njoftimi për kontratë dhe Dosja e tenderit me titull të projektit : **“REHABILITIMI I RRUGËS DHE NDERTIMI I TROTUARIT ARLLAT-NEGROVC DHE VUQAK”** ju njoftojmë se jem të obliguar që të ju drejtohem me kërkesë për Rishqyrtim lidhur me **Përshtatshmëria profesionale, dhe Kapaciteti teknik dhe profesional lidhur me kërkesat/dëshmitë** që janë kërkuar në publikimin e tenderit me titull: **“Rehabilitimi i rrugës dhe ndërtimi i trotuari ARLLAT-NEGROVC DHE VUQAK”***

E kundërshtojmë pjesërisht B05 Njoftim për Kontrate dhe B17 Dosja e Tenderit – Pune - Procedura e hapur. Si OE te interesuar për te qen pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit , i qëndrojmë mbrapa pretendimeve tona me bazën argumentuese se është shkelur Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,

I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092LPP-së .

Ne do të ofrojmë dëshmitë dhe argumente për mes F02.. Formulari Standard për rishqyrtim te vendimit ne AK, edhe pse AK zyra e prokurimit ka mundur me kohë që mos të vendosen kriteret diskriminuese/Favorizuese, duke ju jepur hapësirë te gjithë OE për te ofertuar.

Për veq shkeljeve rreth kriterëve diskriminuese qe janë ber duke favorizuar OE sipas kalkulimeve te AK-së, shkelje tjetër shume me rendësi është sepse AK ka bërë publikimin e tenderit me afat te shkurtër e qe realisht nëse i shikojmë kriteret qe OE duhet për ti plotësuar, na jep te kuptojmë se AK zyra e prokurimit te K Drenasit, kanë ber shkelje flagrante te Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,

I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092LPP-së .

Një veprim i tillë nuk është dashur te behet nga AK, andaj jem të obliguar të ju drejtohem me këtë kërkesë për Rishqyrtim si kusht para dërgimit të lëndës në OSHP-ë

Me poshtë i keni kërkesat dhe dëshmitë sipas Dosjes se tenderit e te cilat mendojmë se janë diskriminuese dhe favorizuese për një grup te OE.

AK ketë procedurë e ka inicuar me afat te shkurtër me arsyetimin sipas AK: Kërkesa bëhet për arsye se mjetet financiare të dedikuara për këtë project janë nga Grandi i Përformancës dhe duhet shpenzuar brenda vitit fiskal 2025. Po ashtu edhe zotimin e mjeteve financiare nga ana e Ministrisë MAPL janë vonuar. çka ka ndikuar që të jemi të vonuar në procedura.

Rekomandim

Ne momentin kur Autoriteti Kontraktues vendos që të bëj publikimin e tenderit me afat të shkurtër detyrimisht është i obliguar që të bëjë Reduktimin e Specifikimeve Teknike.

Sipas provojës, procedura me afat të shkurtër behën për raste emergjente, në momentin kur varësisht prej situatës duhet të kryhet një punë, shërbim apo Furnizim për një kohë shumë të shkurtër.

Ne rastin konkrete te publikohet një tender me afat të shkurte në shumen e paraparë 700,000.00 euro është shkelje e LPP-ë, kjo eshët e definuar edhe ne

Neni 44 LPP

Rregullat e Përgjithshme për Caktimin e Afateve Kohore për pranimin e Tenderëve ose Kërkesave për Pjesëmarrje

1. Çfarëdo afati kohor i caktuar nga autoriteti kontraktues për pranimin e tenderëve, ose kërkesave për pjesëmarrje duhet të jetë i mjaftueshëm për t'iu dhënë operatorëve të interesuar ekonomik, kohë të mjaftueshme për të përgatitur dhe dorëzuar dokumentet në fjalë. Gjatë caktimit të afatit kohor, autoriteti kontraktues do të marrë parasysh qëllimin dhe kompleksi tetin e prokurimit përkatës dhe kontratën që do të jepet, si dhe nivelin e vështirësisë dhe/ose kompleksi tetit të përgatitjes së një tenderi, të përgjegjshëm ose kërkesë për pjesëmarrje.

Neni 46

Rregullat e posaçme për mundësimin e shkurtimit të afateve kohore

1. Nëse ekzistojnë rrethanat që: (i) kërkojnë zbatimin e një aktiviteti të prokurimit në raste urgjente; (ii) e bëjnë të pamundur respektimin e afateve kohore të përcaktuara në nenin 44 të këtij ligji ose nëse është e aplikueshme edhe në nenin 45 të këtij ligji; (iii) nuk shkaktojnë urgjencat e parashikuara nga neni 35.2.1 (iii), nuk mund tu atribuohen veprimeve ose mos-veprimeve të autoritetit kontraktues, autoriteti kontraktues mundet të zbatojë prokurimin me përdorimin e afateve të përshpejtuara kohore që përcaktohen me këtë nen.

35.2.1(iii) nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektive të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedurë tjetër që parashtrohet në këtë ligj. Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet në rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues.

50. Prokurimi Emergjent (UA)

2. Rastet urgjente 50.6 Për rastet urgjente, LPP përmban rregullat që lejojnë reduktimin e afateve kohore për pranimin e tenderëve/kërkesave për pjesëmarrje, neni 46 i LPP-së. Procedurat e tilla quhen “procedurat e përshpejtuara”, dhe afatet e reduktuara kohore quhen “afatet e përshpejtuara kohore”. 50.7 Kushtet për përdorimin e procedurave të përshpejtuara janë se rrethanat nënkuptojnë këto:
 - domosdoshmëria e zhvillimit të një aktiviteti prokurimi në bazë urgjente,
 - aplikimi i afateve normale kohore është i pazbatueshëm,
 - nuk është një situatë emergjente (urgjence ekstreme), dhe
 - rrethanat e tilla nuk i atribuohen veprimeve apo mosveprimeve të autoritetit kontraktues.

AK-ë Komuna e Drenasit është dashur të bëjë planifikimin e prokurimit si duhet për të gjitha procedurat e prokurimit, duke planifikuar afatet e rregullta sipas LPP-së.

Edhe nëse planifikimi i prokurimit nuk është bërë si duhet, duhet të kenë kujdes se një veprim i tillë i shpalljes së procedurave me afat të shkurtër duke paraparë kërkesa ekstreme të vështira për tu kompletuar konsiderohet si shkelje e LPP-ë

III.2.2) Përshatshmëria profesionale:

Kërkesa 2. Kompania duhet të jetë e certifikuar me këto ISO

Dëshmia 2. Kopje të certifikatave dhe të jave valide.

- 1.Sigurimi I menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO IEC 27001 2013,
- 2.Sistemi I menaxhimit të Energjisë ISO 50001 2018,
- 3.Sistemi I menaxhimit të integruar Pas 99 2012 ,
- 4.Menaxhimi I riskut ISO 31000 2018,
- 5.Vlerësimin e thjeshtë seizimik për punë betonike ndërtesa ura ISO 28841 2013

Rekomandim

1.Sigurimi I menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO IEC 27001 2013,

Është një standart ndërkombëtar për menaxhimin e sigurisë së Informacionit , mbrojtje konfidenciale , në rastin konkret nuk ka lidhshmëri të drejtpërdrejtë në procedurën me fjalë. Ky ISO IEC 27001 2013, përdoret për rrugët që përfshin sistemin e teknologjisë së Informacionit , sistem të menaxhimit të trafikut, kontroll elektronik ,Monitorim nga distanca

2.Sistemi I menaxhimit të Energjisë ISO 50001 2018,

ISO 50001 2018 është qertifikat për menaxhimin e konsumit të Energjis gjat rehabilitimit të rrugëve, në raste kur makinerit që përdoren për rehabilitimin rrugës konsumojnë energji të tepërt , ose efikasitete në menaxhimin e karburanteve . në rastin konkret asnjëra për tyre nuk ndikojnë tek profesionalizmi i OE vetëm si e zvogëlojnë konkurrencën e për pasoj AK Komuna e Drenasit mund të dëmtohet për nga ana Financiare

3.Sistemi I menaxhimit të integruar Pas 99 2012 ,

Sistemi i i Menaxhimit të integruar nuk ka lidhshmërinë në aspektin teknik të ndërtimit të rrugëve

Sistemi I menaxhimit të Energjisë ISO 50001 2018,

ISO 50001 2018 është qertifikat për menaxhimin e konsumit të Energjis gjat rehabilitimit të rrugëve, në raste kur makinerit që përdoren për rehabilitimin rrugës konsumojnë energji të tepërt , ose efikasitete në menaxhimin e karburanteve . në rastin konkret asnjëra për tyre nuk ndikojnë tek profesionalizmi i OE vetëm si e zvogëlojnë konkurrencën e për pasoj AK Komuna e Drenasit mund të dëmtohet për nga ana Financiare.

4.Menaxhimi I riskut ISO 31000 2018

AK ka kërkuar një ISO e cila fare nuk korrespondon me terrenin se ku do të bëhet implementimi i punimeve , ky ISO kërkohet të për projekt të Komplex ose në ndikim të madhe të lëvizjeve gjeoteknike,

5.Vlerësimin e thjeshtë seizimik për punë betonike ndërtesa ura ISO 28841 2013

AK ka kërkuar një ISO28841 2013 përdoret tek rrugët e nivelit të lart, rehabilitim i Ura , Tuneleve apo Objekte që janë të ndërlidhura me rrugën, në rastin konkret kur rehabilitimi është vetë shtrimi i asfaltit dhe nuk përfshin struktura një ISO28841 2013, nuk ka arsye për të kërkuar

Kërkesa 4. PAISJET – (Lista e paisjeve - origjinale , Paisjet duhet të jenë me Librez, DUD ose Fatur të bashkangjitur edhe dëshmia bankare e pagesës në rast të shfrytëzimit me qera kontrat me dy palë me titull

të tenderit.)

Dëshmia 4. Lista e paisjeve – Original - Për të gjitha kërkesat rreth paisjeve duhet të ofrohen dëshmitë në opje deshmi (kopjet e librezave - valide , fatura ose DUD-i etj, që kompania i ka në pronësi ose kontratë mbi shfrytëzimin e tyre me qera

Keni kërkuar një **“Minimum 1 person të certifikuar për menaxher i repartit punues i cili është trajnuar dhe certifikuar në bazë të parimeve të ISO 18001 2007, inspektor zbatues i sistemit 18001 OHSAS për puntorët në vendpunishte për të qenë konform me kërkesat që dalin nga aspekti i sigurisë në punë.”** – kjo kërkesë është diskriminuese dhe favorizuese dhe kërkojmë që të largohet. Kjo është një certifikatë standarde menaxheriale që aplikohet në ndërmarrje të mëdha ose projekte industriale me risk të lartë. Në këtë projekt me natyrë të zakonshme rrugore, është kërkesë e tepruar që nuk kontribuon drejtpërdrejt në cilësinë apo sigurinë e realizimit të punimeve.

Keni kërkuar një **“Minimum 1 person të certifikuar për kontrollin e cilësisë së armimit dhe Minimum 1 person të certifikuar për armim”** – Kërkojmë që këto dy kritere të largohen pasi që në paramasë nuk ka asnjë pozicion që përfshin armaturë ose beton të armuar. Prandaj, prezenca e një eksperti për kontroll i cilësisë së armimit dhe armim është jo e justifikuar teknikisht dhe e panevojshme.

Keni kërkuar **“Minimum 15 puntorë. minimum 10 puntorë duhet të jenë të certifikuar për siguri në punë dhe mbrojtje nga zjarri (për shkak të natyrës së rrezikshmërisë së punës).”** Të largohet si kriter detyrues në këtë numër sepse projekti në fjalë nuk përfshin punime në kushte të rrezikshme që kërkojnë një numër kaq të lartë punëtorësh të certifikuar për mbrojtje nga zjarri. Kjo kërkesë është jo proporcionale me natyrën e projektit, i cili ka të bëjë me punime rrugore dhe trotuare në ambient të hapur.

Keni kërkuar **“Minimum 1 person të certifikuar për drenazhim të dheut dhe për trajtimin e mbetje të rrezikshme inerte.”** –Kërkojmë të largohet si jo e arsyetuar ky kriter pasi që në këtë projekt nuk është paraparë asnjë punë me mbetje të rrezikshme. Drenazhi i dheut është i zakonshëm dhe nuk kërkon certifikim specifik. Kjo kërkesë e rëndon padrejtësisht pjesëmarrjen.

Keni kërkuar **“Minimum 1 person të certifikuar për latues.”** – ky kriter është i panevojshëm, dhe duhet të largohet pasi asnjë pozicion në paramasë nuk lidhet me punime të karakterit metalik apo industrial që kërkojnë punë latimi. kërkesa është teknike jo relevante.

Keni kërkuar **“Minimum 1 person të certifikuar për saldues”** - ky kriter është i panevojshëm, dhe duhet të largohet sepse paramasa nuk përfshin konstruksione metalike apo zbatim të profileve metalike që kërkojnë proces saldimi. Kërkesa është jo e lidhur me përmbajtjen reale të projektit.

Keni kërkuar **“Cilindër për ngjeshje të zhavorrit me dhëmbëza min. 10t deri max. 12t”** – këta cilindra përdoren në ngjeshje të dheut të lagësht ose baltës, dhe nuk janë të përfshira në paramasë. Toka në këtë projekt është e stabilizuar dhe parashikohet mbushje me material të klasifikuar (0-63, 0-31.5), që nuk kërkon cilinder me dhëmbëza - Kompaktimi i materialit zhavorror në këtë projekt mund të realizohet në mënyrë të plotë me cilindra klasikë. Kërkojmë që të largohet ky kriter favorizues

Keni kërkuar **“Makinë hidraulike ngjeshëse që montohet në eskavator”**, Nuk ka asnjë pozicion në paramasë që kërkon pajisje kaq specifike. Të gjitha ngjeshjet parashihen të bëhen me cilindër, i cili është më i zakonshëm dhe më efikas për këtë lloj pune. Kërkojmë që të largohet ky kriter.

Rekomandim përfundimtar:

Zyra e prokurimit e AK-së ,Komuna e Drenasit, sa i përket kërkesave të atakuar me lart ose duhet të bëjë korrigjimin e këtyre pikave ose si OE jemi të obliguar që lëndën ta

dërgojmë ne OSHP.

VENDIM

- I. **APROVOHET** e bazuar kërkesa e OE **"InfraCore Sh.p.k"**.
- II. **ANULOHET**, [B05 Njoftim për Kontrate](#) dhe [B17 Dosja e Tenderit – Pune - Procedura e hapur](#)
- III. **DETYROHET** autoriteti kontraktues që Korigjimi i Njoftimit të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimin për kontratë dhe konform dispozitave të **LPP-s dhe** UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK –s

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Këto veprime të Autoritetit Kontraktues jo vetëm që kufizojnë pjesëmarrjen tonë të drejtë në këtë procedurë, por potencialisht na shkaktojnë edhe dëme materiale dhe operacionale nëse nuk ndërpritet menjëherë kjo qasje diskriminuese për të cilën kemi përgatitur dokumentacionin konform të gjitha kërkesave ligjore. Neve si OE na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, përgatitjen e kërkesës për Rishqyrtim, si dhe fitimi i pa realizuar lidhur me këtë kontratë në shumen 20,000.00 euro

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.